

DEPARTAMENTI I SHKENCAVE EKONOMIKE

I. Kriteret për pranimin në programin e Doktoratës në Shkenca Ekonomike për VA 2025-2026

- 1) Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Shkencave Ekonomike ose të përafërta me to.
- 2) Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit me notë mesatare 8 (tetë) e lart (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND).
- 3) Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përgjegjëse për Arsimin.
- 4) Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të Shkencave Ekonomike ose në fusha të përafërta.
- 5) Përparësi do të kenë kandidatet të cilët janë diplomuar në fushën ekonomike dhe biznesit.
- 6) Preferohen kandidatët të cilët shfaqin aftësitë;
- 7) Të menduarit krijues;
- 8) Zhvillimi i sensit kritik lidhur me fushën e kërkimit;
- 9) Lidhjet mes fushave të ndryshme të kërkimit;
- 10) Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës kërkimore;
- 11) Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e kërkimit dhe për të propozuar ide të reja në fushën e kërkimit;
 - a. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
 - b. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar nga udhëheqësi.
 - c. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
 - d. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës nga profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
 - e. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike.
 - f. Kandidati duhet të kenë eksperiencë të paktën 2 (dy) vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një Institucion të Arsimit të Lartë, apo Institucione të kërkimit bazë ose të zbatuar. Përfshihen nga ky kriter studentët e ekselencës.

Kritere të veçanta mund të përcaktohen në varësi të kërkesave specifike të projekteve kërkimore.

II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Shkencave Ekonomike

a. Diploma e fituar, kriteri (a)	<u>(maksimumi 400 pikë)</u>	
i. Bachelor në Shkenca Ekonomike		200 pikë
ii. Master Shkencor në Shkenca Ekonomike		200 pikë
iii. Bachelor, programe të përafërta		150 pikë
iv. Master Shkencor, programe të përafërta		150 pikë
b. Nota mesatare, kriteri (b)	<u>(maksimumi 250 pikë)</u>	
i. 9.51 – 10.00		250 pikë
ii. 9.01 – 9.50		210 pikë
iii. 8.51 – 9.00		180 pikë
iv. 8.00 – 8.50		150 pikë
c. Njohuri në gjuhë të huaja, kriteri (e)	<u>(maksimumi 200 pikë)</u>	
i. Më shumë sesa një gjuhë e huaj		200 pikë
ii. Një gjuhë e huaj		150 pikë
d. Pjesmarje në konferenca dhe revista shkencore, kriteri (j)	<u>(maksimumi 150 pikë)</u>	
i. Më shumë sesa 2		150 pikë
ii. Deri në 2		100 pikë